

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 57726/21

Drita XHEKA

kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 janar 2025, si Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *kryetar*,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 12 nëntor 2021,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Kërkuesja znj. Drita Xheka ka lindur në vitin 1965.

Ankimet e kërkueses sipas nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procesit dhe mungesën e mjeteve të efektshme juridike në këtë drejtim i janë komunikuar qeverisë shqiptare (“Qeveria”), që dorëzoi parashtrimet për pranueshmërinë dhe themelin. Parashtrimet ju dërguan kërkueses, e cila u ftua që të paraqitë parashtrimet e saj. Sekretaria nuk mori asnjë përgjigje për shkresën.

Me shkresën e datës 8 tetor 2024 dërguar me rekomande, kërkuesja u njoftua që periudha e lejuar për paraqitjen e parashtrimeve të saj kishte mbaruar më 8 gusht 2024 dhe nuk ishte kërkuar shtyrje kohe. Në vëmendje të kërkueses u soll neni 37 paragrafi 1 (a) i Konventës, sipas të cilit Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin që kërkuesi nuk ka ndërmend ta ndjekë kërkesën. Kërkuesja e mori shkresën e 29 tetorit 2024. Megjithatë, nuk vijoi asnjë përgjigje.

LEGJISLACIONI

Nisur nga sa më sipër dhe në mungesë të ndonjë rrethane të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa dhe Protokollet e saj, Gjykata, në përputhje me nenin 37 § 1 (a) të Konventës, vlerëson që nuk justifikohet më vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës.

Në këto rrethana, çështja duhet të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Vendos të heqë kërkesën nga lista e çështjeve të saj.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 13 shkurt 2025.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

Oddný Mjöll Arnardóttir
KRYETAR